



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_952_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1579_05_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **20.06.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I.S. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR - 124990** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1579_05_17** i datës 19.05.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: konsumatori është ankuar vetëm për faturat e muajit 07/2015 dhe 08/2015 dhe se jo për muajt paraprak. Në procesverbalin e inspektimit është theksuar se njehsori elektrik xhamin e ka të thyer dhe duhet të ndërrohet me ç'rast edhe është bërë ndërrimi dhe kontrollimi detal i njehsorit elektrik. Sipas procesverbalit të ndërrimit dhe kontrollimit detal nuk do të thotë se faturimi i mëhershëm ka qenë jo i saktë, por që në muajin 07/2015 është konstatuar se xhami i njehsorit është i thyer dhe se ka mundur të shkaktoj çrregullim, dhe se lidhur me këtë është bërë korrigjimi financiar të cilën konsiderojmë se është i saktë.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e ZRRE/DMK_V_1579_05_17 i datës 19.05.2017, në lidhje me shifrën DPR – 124990 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit se konsumatori është ankuar vetëm në faturën e muajit 07/2015 dhe 08/2015, Bordi i ZRRE thekson se edhe përkundër që konsumatori parashton ankesë për një faturë, nëse gjatë analizimit të shkresave konstatohet se ajo faturë ka qenë e faturuar gabim atëherë edhe faturat tjera duhet të korrigjohen. Sipas shkresave të lëndës ka vërejtur se konsumatori për faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën gusht 2015 është ngarkuar me shpenzim prej **16,513 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **1,348.98€**, e që kjo faturë paraqet diferencën në mes leximit të periudhës korrik 2015 i cili lexim është bërë në ditën e ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe kWh të regjistruar në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik të datës 24.07.2015. Bordi i ZRRE-së konstaton se KESCO ka gabuar pasi që shpenzimi i energjisë elektrike i faturuar (kilovatorët – kWh) të muajit 08/2015 dhe i evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive nuk përputhen me gjendjen reale të shpenzimeve të evidentuara në procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr.0168108 të datës 24.07.2015, përkatësisht kWh e faturuara në tarifën e lartë është dashur të faturohen në tarifën e ulët, kurse kWh e faturuara në tarifën e ulët është dashur që të faturohen në tarifën e lartë. Gjithashtu gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrike ka vërejtur se KEDS gjatë faturimit të tarifës së ulët ka gabuar dhe e ka mbi faturuar konsumatorin prej **16,877 kWh**.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin nr.9050152 konstatohet se konsumatori nga fillimi nuk ka lexim dhe faturim të saktë të shpenzimeve mujore përkatësisht përveç mbi faturimit ka edhe mos përcaktim të saktë të kWh të shpenzuar në tarifën e lartë dhe të ulët, e që kjo është në kundërshtim me nenin 28 paragrafet 1, 2 dhe 3 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike, ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”; “2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”; “3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.*

Sipas listave të leximit konstatohet se konsumatori është faturuar gabim duke ndërruar kohën e shfrytëzimit, por që vërehet se në periudhën 07/2015 lexuesi i KEDS-it ka evidentuar gjendjen e cila përputhet me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr. 0934859 datë 24.07.2015, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0168108 datë 24.07.2015 si dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr. 07/31 të datës 31.07.2015, por që KESCO ka dështuar që të marr masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes së faturuar të konsumatorit duke mos respektuar Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përkatësisht nenin 28 paragrafët 1, 2 dhe 3.

Bordi gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës konstaton se për shkak të gabimeve të bëra nga KEDS/KESCO konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi i të gjitha faturave nga periudha 08/2002 deri me datë 24.07.2015, pra korrigjimi duhet të bëhet ashtu që gjendja e saktë e lexuar është TL=28196 kWh dhe TU=86532 kWh (periudha 24.07.2015) dhe gjendja kur është bërë gabimi është TL=2470 kWh dhe TU=9290 kWh (periudha 08/2002).

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I.S. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së